



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 369/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues Ymer Hoxha dhe Hasan Shala anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Mitrovicë, paraqitur kundër subjektit politik Iniciativa Qytetare Mitrovicë dega në Mitrovicë, për shkak të vendosjes së posterave, në seancën e panelit të mbajtur me 01.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), dega në Mitrovicë.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 29.10.2013, nga subjekti politik PDK, dega në Mitrovicë, në të cilën theksohet se me datën 21.10.2013 në orën 15.00 se aktivistët të Iniciativës Qytetare Mitrovica, në objektin e Entit Social në Mitrovicë e kanë vendosur posterin e kandidatit të kësaj Initiative për Kryetar Komune dhe se nga kjo pretendojnë se me këtë veprim ka shkelur nenin 33 pika a të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, neni 3 pika a të Kodit të Mirësjelljes së Subjekteve Politike dhe neni 3.6 për Rregullat Zgjedhore 13/2013, si dëshmi ka bashkangjitur disa fotografi.

PZAP-i, e informoi subjektin politik Iniciativa Qytetare Mitrovica në kuptim të neni 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 30.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 31.10.2013, në ora 12:00. Sipas afatit të caktuar, PZAP-i, pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik Iniciativa Qytetare Mitrovica, në të cilën deklaroi se: posterat janë të ngjitur në një ndërtesë banimi si dhe në një ndërtesë e cila është e përbashkët e entit social ku gjithashtu ka edhe posterat e partive tjera përfshirë edhe PDK. Ky subjekt politik është i gatshëm që t'i largojë posterat brenda një ore si dhe këtë ankesë e shohin vetëm si një tendencë për balancim të asaj qfarë aktivistët e PDK-së kanë bërë me posterat e tyre .

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstatoi se pretendimet ankimore nuk qendërojnë ngase provat e bashkangjitur si dëshmi nuk i identifikojnë pretendimet ankimore prandaj PZAP-i i vlerëson si të pabazuara dhe të pa argumentuara, andaj në kuptim të nenit 115.1 lidhur me 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 369/2013 më datën 01.11.2013

**Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala**



:
Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*